



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština: Skupština Rahovacka / Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 55

Data/Date/Date 30.03/2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72510063-00722-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1689m² (njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), zona kadastrale Polluzhë, e evidentuar në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC.SHKOLLA FILLORE.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 200m² (dyqind metra katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 200m² (dyqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 32/23 i datës 28.02.2023.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe**
- **Arkivi.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.55/23
Me datë:30.03.2023

